

GARË PËR CV DHE INTERVISTË MË TË MIRË

Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë e USHT-së, në bashkëpunim me Projektin për Konkurrencë të USAID-it, përkatësisht programin "KARRIERA IME", me rastin e organizimit të Panairit të Karrierës në USHT, organizon "GARË STUDENTORE PËR CV DHE INTERVISTË MË TË MIRË"

Gara është e hapur për të gjithë studentët e USHT-së, pa marrë parasysh drejtimin studimor apo ciklin e studimeve.

Të gjithë studentët të cilët duan të marrin pjesë në këtë garë, më së voni deri më datë 19 Maj 2010, duhet të dërgojnë CV-të e tyre në adresën elektronike: careercenter@unite.edu.mk

Pesë CV-të më të mira do shpërblehen, po ashtu fituesve do të ju ndahen edhe certifikata nga programi "KARRIERA IME". Ndërsa studenti që do të jetë më i mirë në intervistë – do të dërgohet për punë praktike në kompanitë përkatëse të profilit të tij.

Shpallja e fituesve do të bëhet ditën e mbajtjes së Panairit, gjegjësisht më datë 20 Maj 2010, në ambientet e Qendrës për Shërbime Studentore dhe Karrierë.



Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë

Universiteti Shtetëror i Tetovës - (USHT)
Rruga e Ilindenit, p.n., 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë
Tel: 00 389 44 335 510; Fax: 00 389 44 334 222
E-mail: careercenter@unite.edu.mk; student.services@unite.edu.mk
Web: www.unite.edu.mk